



Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim

**TRAJTIMI I PROBLEMATIKAVE
SOCIALE NE MEDIA –
*Perspektivë gjinore***

Janar – Mars 2009

Tiranë, 2009



Përgatitja dhe botimi i këtij materiali u mundësua nga **OSFA – Fondacioni “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë”**, në kuadër të projektit “Trajtimi i problematikave sociale në media – perspektivë gjinore”, zbatuar nga **“Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim”**.



Autoret: Etleva Martiri
Linda Mëniku
Migena Kapllanaj

© 2009. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për Qendrën e Aleancës Gjinore për Zhvillim”, Tiranë/Shqipëri.

2

Botuar nga: Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim
Kutia Postare 2418, Tiranë
Tel/Fax: (+ +355) 42 255 514/5
E-mail: qdi@gadc-al.org
Web site: www.gadc-al.org

Faqosja & Kopertina: Elvira Osmani

PËRMBAJTJA

HYRJE	5
Fokusi i monitorimit.....	7
Roli i medias në promovimin e barazisë gjinore	8
Gazetarë apo gazetare?.....	9
Gratë subjekte apo objekte të medias?.....	10

GRUAJA NË VENDIMMARRJE DHE POLITIKBËRJE.....13

Analiza e shkrimeve të monitoruar për gratë në vendimmarrje.	14
1. Fushat e pasqyruara	17
2. Shkrimet për përfaqësimin politik të grave.....	19
3. Si pasqyrohen gratë në vendimmarrje?.....	21
3.1. Kur gratë kritikohen.....	22
3.2. Titulli nuk përputhet me lajmin.....	25
4. “8 Marsi” dhe pjesëmarrja e gruas në vendimmarrje.....	26
Konkluzione.....	28

PJESËMARRJA DHE DISKRIMINIMI NË VENDIN E PUNËS 31

Çfarë është diskriminimi gjinor në punësim?.....	31
Analiza e shkrimeve	32
Çështjet kryesore të trajtuara në analizën e shkrimeve të monitoruar	35

1. Fushat e pasqyruara.....	35
2. Individualiteti i shkrimeve	36
3. Punësimi dhe përfshirja e grave.....	37
3.1 Gruaja në pozicione drejtuese.....	41
3.2 Diskriminimi në pagë.....	43
4. Gratë e padukshme.....	43
5. Këndvështrimi nga tregohet historia.....	44
6. Dhuna ndaj grave në vendin e punës.....	45
7. Korrupsioni dhe integrimi gjinor.....	45
Konkluzione.....	46

ANALIZA GJUHËSORE NË MEDIA..... 49

1. Analiza e diskursit të medias.....	49
2. Zgjedhja e leksikut.....	49
3. Emërtimet në media.....	51
4. Përdorimet e përemrave	54
5. Përdorimi i formave modale.....	55
Konkluzione	56

Rekomandime.....	58
Bibliografia	59

HYRJE

Ky raport analizon mënyrën sesi paraqiten dhe si trajtohen në mediat shqiptare femrat dhe problemet të përkatësisë gjinore. Objekti i analizës janë shkrime të medias shqiptare të periudhës Janar-Mars 2009, në të cilët trajtohet tematika e përkatësisë gjinore.

Ky studim është shkruar për të kuptuar rolin e medias në integrimin gjinor dhe veçanërisht në integrimin e grave në jetën ekonomike, përcaktimin e vlerave dhe kufizimeve të medias në kushtet e një shoqërie me orientim maskilist. Media i përshkruan gratë dhe burrat në mënyra të ndryshme dhe këto mënyra formojnë stereotipe të ndryshme të cilat çojnë në përsëritjen e diskriminimit midis burrave dhe grave në jetën e përditshme. Monitorimi i medias është në qendër të praktikave të organizatave që studiojnë dhe mbrojnë çështjet e përkatësisë gjinore, meqenëse kjo është mënyra për të kuptuar rolet gjinore dhe përfaqësimin e gruas në media.

Rolet gjinore¹ i referohen të drejtave, përgjegjësisë, pritshmërive dhe marrëdhënieve të burrave dhe grave. Rolet gjinore nuk janë të njëjta në të gjithë botën. Çdo shoqëri ka pritshmëri të caktuara për burrat dhe gratë, si dhe zhvillon mënyra të formimit të njerëzve që i afrohen këtyre pritshmërive. Evidencat ndërkulturore tregojnë një ndryshim të madh të sjelljeve të sekseve të ndryshëm².

¹ Përfshijnë rolin prodhues, riprodhues dhe komunitar

² Eitzen, 2000:249

Barazia gjinore është një e drejtë themelore qytetare, një vlerë e përbashkët e vendeve të Bashkimit Evropian, e për këtë arsye një kusht i domosdoshëm për integrim dhe realizim të objektivave për punësim dhe kohezion social të MSA, të cilën Shqipëria e ka nënshkruar në Qershor të vitit 2006³.

Nuk mund të ketë zhvillim të qëndrueshëm pa pjesëmarrjen e plotë dhe të barabartë të grave në të gjitha nivelet. Partneriteti dhe barazia midis burrave dhe grave janë baza për familje të qëndrueshme dhe shoqëri të emancipuara.

Ndërsa popullsia rritet, komunitetet bëhen gjithnjë e më të ndërlidhura dhe ndërsa rrjedhja e informacionit ecën shpejt dhe kalon kufijtë e grupeve, më shumë njerëz duan të dinë se çfarë ndodh me grupimet shoqërore të ndryshme, sidomos me ato vulnerabël të shoqërisë. Ata që vuajnë nga pabarazia dhe deprivimi kërkojnë të ndërgjegjësohen për atë ç'ka realisht ndodh në shoqëri, problemet që ekzistojnë dhe rrugët për ti zgjidhur ato.

6

Media, si një pjesë e rëndësishme e komunikimit të shoqërisë, informon publikun dhe reflekton pjesë të opinionit publik. Ajo luan rol kyç në luftën kundër stereotipave gjinore dhe kontribuon në pasqyrimin e një kuadri realist të aftësive dhe potencialit të grave dhe burrave në shoqëritë moderne⁴. Është e rëndësishme, që shtypi të reflektojë rolet gjinore aktuale, supozimet e shoqërisë për çështjet e përkatësisë gjinore, si dhe nevojat për të arritur barazi gjinore. Por me gjithë arritjet dhe zhvillimet në fushën e medias përsëri media nuk arrin të reflektojë pozitën aktuale të gruas në shoqëri dhe shpesh ndodh që problemet reale të grave injorohen apo të mos konsiderohen si çështje të një kategorie të veçantë.

³ Strategjia Kombëtare për Barazi Gjinore

⁴ Diskriminimi në punë në Evropë. Zyra Ndërkombëtare e Punës

Fokusi i monitorimit

Monitorimi i shtypit periodik për periudhën Janar-Mars 2009 është bazuar në analizën sasiore dhe cilësore të artikujve të gazetave të fokusuara në dy çështje kryesore:

- ✓ Pjesëmarrja e gruas në vendimmarrje dhe politikbërje
- ✓ Pjesëmarrja dhe diskriminimi i gruas në vendin e punës

Analiza sasiore është bazuar në mbledhjen e të dhënave sasiore që japin informacion mbi numrin e grave të përfshira në temat e kërkuara, fushat në të cilat janë më të pasqyruara, pozicioni i grave të pasqyruara, mënyra e pasqyrimit, frekuenca e pasqyrimit në secilën gazetë etj, si dhe roli që luajnë në lajm. Ndërsa, analiza cilësore bazohet në përshkrimin e mënyrës se si portretizohen gratë. Kjo analizë shoqërohet me një përshkrim të detajuar të disa artikujve të zgjedhur.

Etika e pasqyrimit të shkrimeve ka qenë në fakt një ndër shqetësimet kryesore me të cilat ky studim është ndalur për të analizuar më në thellësi duke përfshirë këtu përshkrimin e grave sipas stereotipave gjinorë, gjuhën e përdorur, etj.

U monitoruan gjithsej 4 gazeta të përditshme shqiptare, përkatësisht gazetat “Shekulli”, “Shqip”, “Panorama” dhe “Shqiptare”. Arsyeja e përzgjedhjes së këtyre gazetave është se këto janë gazetat më të lexuara në zonat urbane dhe rurale. Përzgjedhja e tyre është bërë duke u mbështetur në përvojën e përgjithshme, në kontaktet e vazhdueshme me përfaqësuesit e medias, pasi në Shqipëri nuk ekziston asnjë mundësi zyrtare për të pasur të dhëna mbi popullaritetin dhe ndikimin e medias në treg dhe në opinionin publik.

Nga monitorimi i artikujve rezultoi se numri i artikujve që trajtonin temat e mësipërme ishte 140, nga të cilat 95 i përkisnin “gruas në vendimmarrje dhe politikë” dhe 45 të tjera fokusoheshin në “punësimin dhe diskriminimin në vendin e punës”.

Të zgjedhësh shkrimet në një periudhë të shkurtër kohore, sigurisht që ka kufizime. Lajmet varen shumë nga ngjarjet e ndryshme që mund të ndodhin, si dhe nga axhendat politike të kësaj periudhe. Nga monitorimi i shpeshëtisë së lajmeve që fokusohen në çështjen gjinore, vihet re se shumica e artikujve i përkasin muajit Mars. Nga 140 artikuj të monitoruar, 87 janë prezantuar në muajin Mars. Kjo shpjegohet me aktivitetet politike që kryhen në periudhën parazgjedhore, ku përfaqësimi i grave në parlament është prioritet, si edhe me Ditën Ndërkombëtare të Gruas, 8 Marsi, ku gazetat “kujtohen” të konsiderojnë “gruan” në shkrimet e tyre.

Roli i medias në promovimin e barazisë gjinore

Media ka një rol të rëndësishëm jo vetëm në pasqyrimin e ngjarjeve më të rëndësishme në vend, por gjithashtu edhe në seleksionimin dhe pasqyrimin e diferencuar të të rëndësishmes dhe të parëndësishmes. Ky kategorizim është ndihmues për lexuesin, sepse fokusohet në atë çfarë është “lajm”, por nga ana tjetër ndikon në formësimin e asaj çfarë është e rëndësishme dhe çfarë jo dhe cilët janë aktorët kryesorë të secilës fushë, duke përforcuar kështu edhe një herë pozicionet e diferencuara të grupeve të burrave dhe grave.


Në fakt media drejtohet dhe përbëhet nga individë, njerëz, profesionistë që në fund të fundit janë pjesë e kësaj kulture dominante, e cila ka përcaktuar tashmë cilët janë të pushtetshmit dhe cilët duhet të jenë. Edhe në këtë institucion të rëndësishëm ndikimi në forcimin dhe ruajtjen e pabarazive gjinore vëmë re të njëjtin ndërtim strukturor dhe të diferencuar të meshkujve dhe femrave. Nga një studim i publikuar nga autorët Tamo & Karaj (2006) vihet re një ndarje e punëve dhe fushave të informimit brenda strukturave mediatike. Nga studimi rezulton se raporti gazetare/gazetarë socialë në median e shkruar dhe atë vizive është 55% me 45%; kulturë – sport 45% kundrejt 55%; politikë 35% kundrejt 65%; analistë 8% kundrejt 92% në favor të meshkujve.⁵ Ky fakt përforcon edhe njëherë faktet e mësipërme në lidhje me pabarazitë në

⁵ Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Kundër Dhunës në Familje 2007 – 2010:25; Tamo & Karaj 2006

vendimmarrje edhe në këtë institucion të rëndësishëm pushteti, i cili nga ana tjetër ndikon në përzgjedhjen e transmetimit/publikimit të informacioneve që formëzojnë mendimin e opinionit publik. Ky reagim zinxhir reflekton problematika serioze në pasqyrimin e drejtë në cilësi dhe sasi të burrave dhe grave në median e shkruar dhe atë vizive. Për atë kohë sa politika, qeverisja, ekonomia shihen si çështje të rëndësishme dhe përbëjnë pjesën dërrmuese të informacioneve që transmetohet në media, janë çështje që “administrohen” nga burrat, atëherë përfshirja në këto struktura dhe pasqyrimi i grave në këto fusha bëhet akoma më i vështirë. Ndarja e rëndësishme e parëndësishme përkon me ndarjen politikë, qeverisje, ekonomi, me sociale, kulturë, sport dhe me ndarjen burra gra brenda këtyre sferave, si në ndërtimin e strukturës mediatike dhe shpërndarjen e detyrave, edhe në pasqyrimin e burrave dhe grave në këto sfera.

Gazetarë apo gazetare?

Për fat të keq nga shkrimet e pasqyruara në *Grafikun Nr. 1*. jepen shpeshherë vetëm inicialet e gazetarëve/eve gjë që e bën të vështirë analizën se kush e ka pasqyruar lajmin një femër apo një mashkull për të parë nëse ka diferencë në mënyrën e pasqyrimin të lajmit nga gazetarët dhe gazetaret dhe për më tepër për të parë se çfarë çështjesh mbulon më tepër secili grup.



Grafiku 1. Numri i shkrimeve të shkruar sipas gazetarëve/eve


Ajo që rezulton është se janë të identifikueshëm 40 shkrime të shkruar nga meshkujt dhe 17 shkrime të shkruar nga femrat, ndërkohë që 66 shkrime janë me initiale ose pa emra. Kjo e vështirëson analizën për të parë fushat që mbulon secili gazetar/e dhe numrit të shkrimeve të shkruar për secilin grup.

Gratë subjekte apo objekte të medias?

Në analizë u morën në konsideratë edhe pozicioni që mbajnë gratë lidhur me shkrimet e pasqyruara në media. Ajo që bie në sy është që gratë e përmendura apo të intervistuar janë kryesisht drejtuese, kryetare të një grupi parlamentar, drejtuese kuvendi, kryeprokurore etj, më pak janë eksperte, zëdhënëse, sekretare, punëtore. Nisur nga ky fakt në mënyrë llogjike arrin në konkluzionin se për të qenë subjekt i pasqyrimin në media duhet të kesh një post, duhet të jesh drejtues dhe mundësisht të jesh burrë, pasi mundësia për tu promovuar është më e madhe.

10

Për ta plotësuar edhe më tej analizën u shqyrtuan shkrimet për të parë nëse këto gra ishin subjekt apo objekt i lajmit të pasqyruar dhe rezultoi se vetëm në 29% të rasteve ato ishin intervistuar, duke qenë edhe informuesja kryesore e lajmit në 66% të rasteve ishin përmendur si pjesë përbërëse e lajmit dhe 7% ishin të përmendura nga të tretë (kur dikush i kritikon, ose i përmend për një ngjarje të caktuar). [Shiko *Grafikun Nr.2.*]



Grafiku 2. Gratë të intervistuar apo të përmendura

Nga ky deduktim është e qartë se fjala e gruas lihet në hije dhe opinioni i tyre personal nuk ka rëndësi, ajo që ka rëndësi është fjala e të tretëve që mesa duket edhe në shkrimet ku flitet për punësimin apo pjesëmarrjen e gruas në vendimmarrje mendimi i të tretëve është më i rëndësishëm.

Veçdhimi

Ja çfarë ka ndodhur në grafikon e deputetëve të rinj. Mes 140 deputetëve të ardhshëm, 21 janë femra, të ndara këtu mes dy partive kryesore. Një paanarë të shpërndarjes së tyre nëpër qatër, us propozojmë më poshtë



III. Justina Durrës

Kryetari i Komitetit Justina Durrës ka bërë si zakazi në Durrës e Durrësi, vendlindja e saj ka qënë njëra nga ato që ka shprehur interesin më të fortë për të kandiduar në listat e deputetëve të rinj të Partisë Socialiste dhe Partisë Demokratike. Në këtë rast, Durrës është njëra nga ato qytete të cilat kanë shprehur interesin më të fortë për të kandiduar në listat e deputetëve të rinj të Partisë Socialiste dhe Partisë Demokratike.

>> Kontestimi | Xhafaj: Komisionerët e PD-së po largohen nga numërimi



SHKURT: Komisionerët e Partisë Socialiste po largohen nga numërimi i deputetëve të rinj të Partisë Demokratike. Xhafaj ka bërë një deklaratë në këtë drejtim, ku ka thënë se komisionerët e PD-së po largohen nga numërimi i deputetëve të rinj të Partisë Demokratike. Xhafaj ka bërë një deklaratë në këtë drejtim, ku ka thënë se komisionerët e PD-së po largohen nga numërimi i deputetëve të rinj të Partisë Demokratike.

SHV
 Në
 të njëjtë
 mënyrë
 si
 deputetë



DEPUTETË
Partia Socialiste merr me gra atë Demokratike
Nga kampi i majtë do të jenë 11 femra deputete në Parlament, nga i djathtë 10

Në Parlament, ajo që ka bërë më shumë sesa edhe në listat e kandidatëve është fakti se për herë të parë, Partia Socialiste dhe Partia Demokratike kanë bërë një marrëveshje për të përfshirë në listat e deputetëve të rinj të Partisë Socialiste dhe Partisë Demokratike. Në këtë rast, Durrës është njëra nga ato qytete të cilat kanë shprehur interesin më të fortë për të kandiduar në listat e deputetëve të rinj të Partisë Socialiste dhe Partisë Demokratike.

Në Komitetin e Kandidimit, Justina Durrës ka bërë si zakazi në Durrës e Durrësi, vendlindja e saj ka qënë njëra nga ato që ka shprehur interesin më të fortë për të kandiduar në listat e deputetëve të rinj të Partisë Socialiste dhe Partisë Demokratike. Në këtë rast, Durrës është njëra nga ato qytete të cilat kanë shprehur interesin më të fortë për të kandiduar në listat e deputetëve të rinj të Partisë Socialiste dhe Partisë Demokratike.

Nga Xhafaj (shtet), ka bërë një deklaratë në këtë drejtim, ku ka thënë se komisionerët e PD-së po largohen nga numërimi i deputetëve të rinj të Partisë Demokratike. Xhafaj ka bërë një deklaratë në këtë drejtim, ku ka thënë se komisionerët e PD-së po largohen nga numërimi i deputetëve të rinj të Partisë Demokratike.

GRUAJA NË VENDIMMARRJE DHE POLITKBËRJE

Pavarësisht ndryshimeve që kanë pasuar zhvillimin e gruas sot jo vetëm në Shqipëri, por edhe në botë, ende vihet re një hendek mes kapacitetit dhe nevojave të tyre dhe burimeve që ato disponojnë; arsimimit, punësimit, përfshirjes në vendimmarrje.

Niveli i ulët i përfaqësimit të gruas në vendimmarrje është një çështje e ndikuar nga shumë faktorë socialë-kulturorë, ekonomikë, strukturorë, shoqërorë etj.

Sot pas afërsisht 100 vjetësh nga fitimi i të drejtës së votës dhe të drejtës për tu zgjedhur, gratë në Shqipëri kanë një nivel shumë të ulët përfaqësimi në nivel vendimmarrës. Kështu përqindja e grave në parlament për vitin 2008 është 7.1%, që në nivel ndërkombëtar na rendit të 114 nga 130 vende të botës (92% e popullsisë së botës).

Pjesëmarrja e ulët e grave dhe vajzave shqiptare në vendimmarrje paraqitet në nivele të ulëta edhe në poste drejtuese në qeverinë qendrore me vetëm 11 poste⁶ dhe vetëm 2% të drejtuesve në qeverisjen vendore⁷ ndërkohë që në asnjë botim apo literaturë nuk “guxohet” të diskutohet për mundësinë e grave shqiptare, si kryetare shteti (kryeministre apo presidente), duke qenë se historia tregon se nuk kemi asnjë rast të tillë.

⁶ Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Kundër Dhunës në Familje 2007 – 2010: Shifrat ju referohen pozicioneve: Ministre, Zëvendësiministre, Sekretare e përgjithshme deri në muajin Tetor 2006; Burimi: Drejtoria e Politikave për Shanse të Barabarta.

⁷ Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Kundër Dhunës në Familje 2007 – 2010: 15

Të gjitha këto pabarazi në vendimmarrje janë të kushtëzuara nga shumë faktorë ekonomikë gjithashtu. Në 60 vende të botës, gratë fitojnë rreth 50% më pak të ardhura se burrat; ato përbëjnë rreth 39% të punonjësve të paguar, por 62% të punonjësve të papaguar në familje⁸.

Barazia gjinore nuk është një çështje e grave, siç cilësohet rëndom, por është një çështje e barazisë mes grupeve të burrave dhe grave, e shanseve të barabarta mes tyre në të gjitha fushat e jetës nga drejtimi i familjes tek qeverisja e një shteti. Ajo është një proces integrimi që synon zhvillimin e shoqërisë, në nivelin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, në nivel social, në nivel të drejtash civile dhe politike duke pasur mundësi të barabartë për të ushtruar të drejtën për të zgjedhur dhe për tu zgjedhur.


Analiza e shkrimeve të monitoruar për gratë në vendimmarrje

14

Qëllimi kryesor i këtij monitorimi është të analizojë mënyrën se si janë pasqyruar gratë në vendimmarrje në median e shkruar.


Gjatë kësaj periudhe Janar - Mars 2009, u monitoruan gjithsej 95 shkrime të botuar në katër gazetat e sipërpërmendura që trajtonin çështjen e pjesëmarrjes së gruas në vendimmarrje dhe politikë. Nga analiza u vu re se këto shkrime zinin një hapësirë jo të konsiderueshme në gazetë. Shkrimet varionin nga informacione të shkurtra prej dy paragrafë (në formë njoftimi), në shkrimet më të zgjeruara dhe në analiza relativisht të hollësishme. Duke ju referuar të dhënave dhe *Grafikut Nr.3* rezulton se në total gazeta Shekulli ka pasqyruar 18 shkrime; gazeta Shqip 21 shkrime; gazeta Shqiptare 32 shkrime dhe Panorama 24 shkrime.

⁸ The Global Gender Gap Report 2008




Grafiku 3. Numri total i shkrimeve për çdo gazetë

Nga *Grafiku Nr. 4* duket që muaji Janar ka pasur një numër të pakët shkrimesh, duke ardhur në rritje në muajt në vazhdim. Në këto muaj vëmendja e shtypit duket e fokusuar më shumë në procesin zgjedhor, ku kuota prej 30% e përfshirjes së gruas në politikbërje dhe vendimmarrje ka qenë një nga debatet më të diskutuar dhe që zinte një hapësirë relativisht të konsiderueshme në faqet e gazetave.



Grafiku 4. Numri i shkrimeve për çdo gazetë

Analiza u fokusua gjithashtu dhe në monitorimin ditor të shkrimeve të pasqyruara në gazeta. Muaji Mars ka edhe numrin më të lartë të shkrimeve krahasuar me dy muajt paraardhës, ku përfshirja e gruas në politikbërje dhe vendimmarrje është më lartë me rreth 49 shkrime. *Grafiku Nr. 5* pasqyron shkrimet për gratë në politikbërje dhe vendimmarrje dhe sikurse shihet gjatë muajit Mars ka vetëm një rast në gazetën Panorama me tre shkrime në datën 25; pesë data me nga dy shkrime në disa prej gazetave dhe pjesa tjetër ka më pak se një artikull në ditë për gazetë.




Grafiku 5. Numri i shkrimeve të pasqyruar në të katër gazetat gjatë muajit Mars 2009

Në fakt me një llogjikë të thjeshtë çdokush do të thoshte se media e shkruar dhe vizive pasqyron ato çështje që përbëjnë lajm, dhe mesa duket numri i grave të pasqyruara reflekton numrin e grave realisht në proceset vendimmarrëse. Por në fakt si do ta shohim edhe më poshtë ka një pasqyrim jo plotësisht përfaqësues të grave në pozicione vendimmarrëse.

Pas kësaj analize dhe duke ju referuar *Grafikut Nr. 6* u bë një tjetër shqyrtim i shkrimeve për të parë se sa ishte numri i grave në total të përmendura dhe rezultoi se gjatë tre muaj monitorimi në katër gazeta kryesore janë të përmendura gjithsej 18 gra në pozicione vendimmarrëse, 12 prej të cilave mbanin pozicionin e drejtueses, dhe 6 të tjera ishin zëdhënëse, sekretare dhe eksperte. Pra

pavarësisht përqindjes 71.8% të grave drejtuese në media në total ato përbëjnë vetëm 12 gra në pozicione drejtuese të cilat janë pasqyruar më shpesh dhe përbëjnë këtë përqindje.




Grafiku 6. Pasqyrimi i pozicioneve të gruas

I. Fushat e pasqyruara

Pavarësisht se ka ndryshime të ndjeshme në lidhje me pozicionin e gruas në politikbërje dhe vendimmarrje sot krahasuar me disa vite më, parë niveli i përfaqësimit të tyre në pozicione të rëndësishme është tepër i ulët. Kur flasim për gratë në politikbërje dhe vendimmarrje kemi parasysh edhe gra që kanë pozicione të tjera vendimmarrëse në institucione në një nivel më të ulët hierarkik dhe strukturor. Nga analiza e artikujve rezulton se media është pak ose aspak e fokusuar në këto pozicione pasi fokusi i tyre janë çështjet e rëndësishme, ato që përbëjnë lajm duke i shërbyer publikut në informimin për ngjarjet më kryesore.

Nga një vështrim i përciptas i gazetave vihet re një përqëndrim i madh në një grup çështjesh që mund të konsiderohen më të rëndësishme, të tilla si: procesi zgjedhor, integrimi në Evropë, debatet mes partive politike, drejtësia dhe ligji. *Grafiku Nr. 7* reflekton qartë se edhe pse të pakta në numër gratë e angazhuara në këto fusha janë të pasqyruara më shpesh në këto gazeta krahasuar me gra në fusha të tjera vendimmarrje.



Grafiku 7. Numri i shkrimeve për përfshirjen e gruas në politikbërje e vendimmarrje

Ndarja gjinore e punës dhe profesioneve është e reflektuar më së miri në pozicionet drejtuese që mban secila gjini. Ndërkohë që axhenda e lajmeve është e dominuar nga proçesi zgjedhor, drejtësia, politika, integrimi, dhe si duket edhe nga grafiku këto çështje që përbëjnë edhe ato që quhen çështje të “forta” zënë 79.2% përkundrejt 20.8%, që zënë çështjet që konsiderohen të “buta” ose më pak të rëndësishme për tu pasqyruar në media siç janë: çështjet sociale, arsimimi, shëndetësia etj.

Por cili është impakti për pozicionin e burrave dhe grave në jetën publike?

Nga njëra anë nëpërmjet përzgjedhjes që media bën për të rëndësishmen dhe të parëndësishmen lë në hije një sërë çështjesh që janë me interes për lexuesin siç janë: arsimi, shëndetësia, çështjet sociale, kur në fakt lënia në hije në gjuhën e medias përkthehet mungesë vëmendje ndaj informacionit në një grup çështjesh jo më pak të rëndësishme për tu informuar.


Nga na tjetër reflektimi i kësaj ndarjeje edhe në pasqyrimin e çështjeve në media thekson edhe më tej këtë hendek duke përforcuar akoma më shumë stereotipat gjinorë.

Një tjetër reflektim i pasuar nga analiza e mësipërme është edhe fakti se nëse 79.2% e shkrimeve flasin për zgjedhje, drejtësi, politikë dhe integrim, atëherë është shumë e qartë situata e pasqyrimin në media të grave në proçese vendimmarrëse, ato janë shumë pak të përfaqësuar. Pra, 76 shkrime për tre muaj në katër gazeta kryesore për gratë në çështjet e rëndësishme dhe vetëm 20 shkrime për gratë në pozicione të tjera vendimmarrëse.

Në fakt nuk është rastësi që gratë janë pak të përfaqësuar në pozicionet vendimmarrëse. 7% përfaqësim i grave në jetën politike të vendit (në parlament dhe poste ministrore) është një përqindje që na rendit pas 106 vendeve të tjera të botës (mes 130 vendeve në total). Por nëse media nuk është e ndjeshme ndaj perspektivës gjinore dhe që në rastin konkret nuk është e vëmendshme ndaj kësaj ndarjeje që ekziston mes çështjeve të rëndësishme dhe jo, çështja e informimit dhe ndërgjegjësimit publik për këtë të drejtë të grave dhe për kontributin që ato kanë dhënë deri tani mbetet një çështje pak e pasqyruar dhe pak e njohur nga opinioni publik.

2. Shkrimet për përfaqësimin politik të grave

Gjatë tre muajve të monitorimit Janar–Mars 2009 ka pasur pak shkrime që flasin për përfaqësimin politik të grave. Në total janë 11 shkrime. Nëse do ti rendisnim për nga rëndësia që i është kushtuar përfaqësimit të grave në vendimmarrje në secilën nga nënndarjet e mëposhtme si për në numër shkrimesh edhe në gjatësinë e shkrimeve, mund të thuhet pa hezitim se proçesi zgjedhor zë vendin kryesor. E njëjta gjë reflektohet edhe nga analiza e mësipërme në *Grafikun 8*, ku çështjet e proçesit zgjedhor janë më të pasqyruarat në media. Të katër shkrimet janë shkrime të gjatë dhe në fokusin e analizës së tyre është çështja e kuotave (mos) respektimi i tyre nga partitë politike dhe qëndrimet e KQZ ndaj këtij kriteri në veçanti.



Grafiku 8. Numri i shkrimeve për përfaqësimin politik të grave

Vlen të theksohet se në të katër shkrimet është pasqyruar një analizë e detajuar e procesit të përfaqësimit të grave në zgjedhjet e ardhshme. Shkrimet nxjerrin në pah problematikat reale të përfaqësimit të grave në bazë të ligjit “Për barazinë gjinore në shoqëri”. Gazeta “Shekulli” i ka kushtuar dy shkrime brenda muajit Mars, përkatësisht në datat 25 dhe 29 Mars. Të dy shkrimet janë të shkruar nga i njëjti gazetar dhe përveç pasqyrimit të të rejave nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve gazetari ndalet edhe në problematikat e implementimit të ligjit.

Siç shihet edhe nga tabela e mësipërme janë pasqyruar edhe dy shkrimet që informojnë aktivitetet e dy institucioneve ndërkombëtare në promovimin dhe ndihmesën që do të japin për të mbështetur pjesëmarrjen e grave në politikë. Shkrimet janë shumë të shkurtër dhe më shumë duket se janë njoftime (ku njëri flet për një sondazh të bërë dhe tjetri për një projekt të iniciuar).

Padyshim urimet e drejtuesve të politikës me rastin e 8 Marsit kanë pasur në fokusin e tyre pjesëmarrjen e grave në politikë. Janë pasqyruar pesë shkrime në datën 9 Mars, ku drejtues të forcave të ndryshme politike në vend urojnë gratë me rastin e Ditës

Ndërkombëtare të Gruas dhe nxisin pjesëmarrjen e tyre në politikë. Titujt që shoqërojnë urimet për këtë ditë janë:

- ✓ *Presidenti uron gratë për festën e 8 marsit; Thirrje femrave për pjesëmarrje më të lartë në politikë (Gazeta Shqiptare 09.03.09)*
- ✓ *Ndoka: Gratë emancipojnë politikën (Gazeta Panorama 10.03.09)*
- ✓ *Rama: pas zgjedhjeve gruaja me rol të ri (Gazeta Shekulli 09.03.09)*
- ✓ *Kryetarja e kuvendit hapi dje dyert e kuvendit. Ajo bëri thirrje për më shumë përfaqësim të grave në politikë (Gazeta Shekulli 09.03.09)*

Një vëmendje e medias ndaj mundësisë së barabartë në përfaqësim është një shenjë e mirë drejt promovimit të grave në vendimarrje.

3. Si pasqyrohen gratë në vendimarrje?

Ndarja e madhe mes çështjeve të rëndësishme dhe të parëndësishme reflekton ndarjen mes burrave dhe grave si aktorë kryesorë të secilës çështje. Është interesant fakti që kur bëhet fjalë për çështje të rëndësishme, artikulli zakonisht plotësohet me intervista dhe mendime të personazheve të tjerë politikë që zakonisht janë meshkuj.

“Deputetja e PS komenton problemin e kartave”.... sekretarja e ndërkombëtare e PS A. D. tha se.... “shqetësimi ynë për kartat e identitetit është kuptuar qartë... dhe ne përsërisim propozimin tonë për pajisjen e shtetasve me kartat e identitetit falas për të mos ju hequr të drejtën për të votuar personave me të ardhura të pakta financiare... Edhe deputeti socialist T.B theksoi të njëjtin konkluzion.... krijimin e lehtësirave për shtetas më të varfra të popullsisë.” (Gazeta Shqiptare; 21.03.09)

Informacioni i dhënë nga të dy deputetët e përmendur në lajm është i njëjtë dhe pozicioni që ata mbajnë është gjithashtu i njëjtë, deputetë të opozitës. Por mendimi i deputetit mashkull, edhe pse është i njëjtë me atë që ka thënë kolegja e tij është cituar për të plotësuar çështjen në fjalë.

Një tjetër shembull është edhe lajmi për raportin e Bankës Botërore rreth krizës në Shqipëri, ku pasqyrohet fotoja e një gruaje përfaqësuese të Bankës Botërore dhe jepet një koment i një përfaqësuesi burrë të OSBE (Gazeta Shqiptare 24.03.09). Në fakt në pamje të parë të krijohet përshtypja se gazetari/ja është përpjekur të plotësojë me informacion lajmin, por ndërkohë në mënyrë të pandërgjegjshme i është bashkangjitur stereotipit se burrat flasin për çështjet e rëndësishme dhe gratë për çështje të parëndësishme.

Po në këtë kontekst në gazetën Shekulli pasqyrohet një artikull që kritikon nismën e një deputeteje dhe përfaqësuese të lartë të politikës shqiptare në lidhje me një revistë për veprimtarinë e institucionit që ajo drejton. Veç të tjerash në artikull thuhet se revista është përdorur vetëm për reklamim të aktivitetit personal të këtij personazhi publik. Çuditërisht janë intervistuar edhe dy personazhe të tjerë që “rastësisht” janë gra. (Gazeta Shekulli 06.02.09.) Por a është e rëndësishme të marrim lentet gjinore dhe të shohim me kujdes mënyrën e pasqyrimin të burrave dhe grave në procese vendimmarrëse?

Media me shtrirjen dhe rëndësinë që ka veçanërisht në realitetin shqiptar ka një pushtet të padiskutuar kryesisht në prezantimin e modeleve pozitive dhe negative, ruajtjen dhe pasqyrimin e asaj çfarë është e drejtë dhe çfarë është e gabuar, duke riprodhuar në këtë mënyrë edhe stereotipet gjinore që janë aq shumë të rrënjosura në kontekstin kulturor dhe social shqiptar. Duke pasur këtë rol të padiskutueshëm, media mund të ndikojë në riformëzimin e këtyre pritshmërive që shoqëria ka për burrat dhe gratë, së pari duke u treguar e kujdesshme në mënyrën e raportimit të lajmit duke e “pastruar” nga stereotipat gjinorë.

3.1 Kur gratë kritikohen

Ashtu si të gjithë personazhet publikë dhe në poste të rëndësishme vendimmarrëse edhe gratë ndodh që të kritikohen për arsye të

ndryshme në lidhje me detyrën që kanë nga kolegë, por edhe kundërshtarë politikë. Ka raste kur për të kritikuar një personazh publik bëhet një identifikim i tij me grupin gjinor të cilit ky personazh i përket, duke përgjithësuar në këtë mënyrë problematikën individuale me karakteristikat e grupit. Në një artikull të pasqyruar në gazetën Shqiptare me titull **“Grarishte”** autori shprehet:

“ ... për t’iu përgjigjur këtyre femrave që me gojë të shturur dhe dorë të hekurt kërkojnë të dhunojnë të drejtat e kolegëve... madje edhe në përpjekjet për t’ia mbyllur gojën kolegëve të saj të kujton ato gratë provinciale të qëmotit që kur kalonte oxhakëshirësi sokakëve gjenin rastin për ti bërë zap fëmijët duke i trembur se erdhi tartakuti... (Gazeta Shqiptare 12.02.09) ”

Kritika e tij ndaj personazhit në fjalë nuk ndalet me kaq, ai bën një paralelizëm me një thënie në një komedi të Shekspirit dhe shprehet:

“ s’kam mend veç sa një grua, e quaj të tillë sepse e quaj të tillë... por keq është kur ashtu grarishte në një kohë kur zhvillimet e pritshme kanë peshën e ndarjes nga e kaluara..... fjala është për emërimin e një anëtareje të, KQZ e cila është përfolur edhe si shoqe muhabeti e J.T. dhe quhet V.SH.’ (Gazeta Shqiptare 12.02.09) ”

Sikur për ta përmbyllur idenë e komentit gjinor që mund të bëhet në një rast të tillë, ku jo të gjitha gratë paraqesin të njëjtat karakteristika dhe autori nuk ka arsye të bëjë një krahasim të tillë, e mbyll artikullin e tij duke u shprehur:

“ Në legjislaturën e ardhshme, mendohet që të jenë protagoniste gra dhe vajza në jo më pak se një të tretën e tërë trupës së deputetëve... mjafton që rolin e tyre prej legjislatori të mos e përkufizojnë me muhabete dhe hallakatje pazari të grarisë veçse duke trokitur për çdo rast në derën e sistemit juridik, për të mos tentuar të sundojnë mbi ligjin që ato vetë e kanë miratuar por që ligji vetë të sundojë edhe mbi to. (Gazeta Shqiptare 12.02.09) ”

Në fakt një deklaratë e tillë përforcon edhe njëherë skepticizmin dhe frikën për të pranuar përfaqësimin e grave në politikë, si e drejtë e tyre themelore, si qenie njerëzore, si shtetase me të drejta të barabarta, një të drejtë që iu garantohet me ligj të gjithëve. Kur flasim për gratë dhe të drejtën e tyre në vendimmarrje nuk flasim për një grupim shoqëror që gjithashtu ka të drejtë të barabartë me këdo tjetër të cilitdo grup shoqëror, por po flasim për gjysmën e botës, për atë gjysmë të cilës e drejta për të vendosur dhe për tu përfaqësuar i është mohuar për shumë shekuj me radhë.

Ky skepticizëm në fakt është i pranishëm në ajër, ndihet pak në një artikull dhe pak në një tjetër diku në një deklaratë të dikujt të rëndësishëm, në opinionin e një gazetari që nuk i shpëton dot stereotipeve si pjesë e kësaj shoqërie, duke përforcuar padashur, por padrejtësisht atë paragjykim që i ka mohuar këtë të drejtë themelore kësaj pjesë të shoqërisë, gjysmës së saj.

24

Një tjetër shembull i kësaj natyre vjen nga gazeta Panorama, ku autori i artikullit bën një kritikë për palën politike në opozitë në lidhje me një deklaratë të pasqyruar nga zëdhënësja e saj L.SH.. Shkruesi i artikullit kritikon ashpër deklaratën dhe palën politike në fjalë, por përdor ironinë dhe sarkazmën për zëdhënësen që ka dhënë lajmin një ditë më parë.

“ ... mbase do të kalojë në heshtje akuzën që lëshoi pa iu dridhur qerpiku zëdhënësja e radhës së P... që i fusin të gjithë në një thes këta të rinjtë e kontrabanduar këtë e kam marrë vesh prej kohësh por që nuk po del një burrë tamam e ta ndalë këtë soj standarti, këtë nuk po arrij ta dëshifroj tamam... duke i ç'burruar deri në këtë pikë nxjerr tani edhe Sh. e të tjerë si ajo ... (Panorama, 09.03.09) ”

Në rastin në fjalë autori përdor zëdhënësen për të bërë një kritikë kundër forcës politike pjesë e të cilës ajo është. Por ajo që është e pakuptimtë është lidhja që ai bën mes zëdhënëses që ka cilësinë e dhënies së lajmit për forcën politike në fjalë dhe kritikave ndaj forcës

politike që ajo përfaqëson. Në të dy rastet e mësipërme të bie në sy tendenca për të përdorur mite dhe paragjykime gjinore duke kritikuar jo vetëm gratë në fjalë, por të gjitha gratë.

Përpiquni për një çast të lexoni artikullin e mësipërm duke imagjinuar në vendin e zëdhënësës një zëdhënës!! A do të kishte përdorur autori të njëjtën gjuhë?

3.2 Titulli nuk përputhet me lajmin

Në ndonjë rast ka shkrime kur titulli me synimin për të tërhequr vëmendjen nuk përputhet me informacionin që analizohet në artikull, duke iu dhënë lexuesve tjetër mesazh.

Në një artikull të pasqyruar tek gazeta Shqiptare në titull shkruhet:

“ Stone: Arritje, më shumë gra në Kuvend
30% përfaqësim është kuota më e lartë që kam parë.
(Gazeta Shqiptare; 27.03.09) ”

Ndërkohë që në intervistën që ekspertja amerikane ka dhënë për këtë gazetë shprehet se:

“ ...30% është ndër përqindjet më të larta që kam parë në krahasim me vendet ku kam qenë... (Gazeta Shqiptare; 27.03.09) ”

Cila është arsyeja që gazetari ndryshon thënien e ekspertës, duke e shprehur me terma absolutë? Ndërkohë që çështja e përfaqësimit 30% është një çështje shumë e diskutuar së fundmi dhe nuk është një kuotë që e ka ndërmarr vetëm Shqipëria. Madje nisur nga studime ndërkombëtare rezulton se Shqipëria është ndër vendet e vonuara në këtë drejtim.

10 nga 30 vende evropiane e kanë përfaqësimin e grave në parlament më shumë se 30% (Në rend zbritës Suedia, Holanda, Finlanda, Danimarka, Spanja, Belgjika, Austria, Gjermania, Islanda, Portugalia), 8 të tjera e kanë mes 20 dhe 30% (Lichtenstein, Luxembourg, Lituania,

Bullgaria, Letonia, Polonia, Estonia, Britania e Madhe)⁹.

Për më tepër kjo nismë ligjore nuk garanton kurrësi këtë përfaqësim të grave pas zgjedhjeve, por do të ndikojë ndjeshëm në rritjen e numrit të tyre, pasi ashtu si e shpjegon gazetari më poshtë në artikull ekzistojnë shumë pengesa të tjera në procesin zgjedhor që pengojnë një përfaqësim të grave në këtë përqindje.

Për shkak të shumë faktorëve historikë, socialë, kulturorë, gratë janë më pak të angazhuara në pozicione drejtuese. Por kjo nuk do të thotë që figurat e grave në vendimmarrje nuk ekzistojnë. Nëse shihet me kujdes vendet që kanë një përfaqësim më të lartë të grave në parlament, janë ndër vendet më të zhvilluara në Evropë dhe kjo sigurisht nuk është rastësi, por një indikator zhvillimi.

4. “8 Marsi” dhe pjesëmarrja e gruas në vendimmarrje

26

Dita Ndërkombëtare e Gruas, ka pasur vëmendjen e të katërt gazetave të monitoruara. Shkrimet që flasin për 8 Marsin janë shkrime të shkurtër të shoqëruara me foto relativisht të mëdha (në raport me sasinë e tekstit). Vetëm gazeta Shqiptare i ka vënë një titull që flitet për festën e 8 marsit “*Dita Ndërkombëtare e Gruas*”. Gazeta Shekulli e ka klasifikuar artikullin në seksionin “POLITIKË” dhe vetëm pasi lexon artikullin kupton se bëhet fjalë për një urim për 8 Marsin nga një drejtues i opozitës. Me shkronja të mëdha në këtë artikull shkruhet “*Pas zgjedhjeve gruaja me rol të ri*”; me shkronja më të vogla sipër shkruhet “*Për 8 Marsin kryetari i opozitës bëri publike disa nga zgjidhjet që do të japë programi i tij për gruan*” Ka dhe një artikull tjetër për 8 Marsin në po këtë gazetë me titull me shkronja të mëdha “*Riorganizimi i P., gratë nuk votohen*” pak më poshtë si nëntitull shkruhet “*Nga P., asnjë prej kandidatëve femra nuk ka mundur të fitojë në ato degë ku mbahen zgjedhjet*”. Pasi lexon artikullin gazetari/ja

⁹ Përqindja e grave në Parlamentet Kombëtarë 30 vendet Europiane

shpjegon arsyet reale pse gratë nuk kanë fituar. Në pjesën e fundit të tij gjithashtu shkruhet se një nga funksionaret më të larta të kësaj force politike uron gratë me rastin e 8 Marsit. Pavarësisht qëllimit të gazetarit/es për të shpjeguar arsyet reale të mosvotimit të grave të tilla si mungesa e promovimit të tyre brenda partisë, strukturat dhe mënyra e përzgjedhjes së kandidatëve vështirësojnë zgjedhjen e grave etj; titulli dhe nëntitulli i artikullit të jep tjetër mesazh; të duket sikur problemi qëndron tek gratë që nuk zgjidhen.



Gazeta Panorama ka pasqyruar një artikull, ku një drejtues i një prej partive të vogla uron gratë me rastin e 8 Marsit dhe thekson faktin se gratë ndikojnë në emancipimin e shoqërisë. Edhe në këtë rast artikulli ndalet në zgjedhjet e ardhshme, ku citohet fjala e drejtuesit të partisë në lidhje me kandidimin e dy grave anëtare të kësaj partie në krye të listave në dy zona të ndryshme. Artikulli është i shkurtër dhe nuk ka foto ilustruese.

Po me rastin e 8 Marsit, një funksionar i lartë i shtetit uron gratë me rastin e festës dhe shprehet:

“

... është koha që gratë të mbështeten për përfshirjen e tyre në politikë, pasi tashmë po dëshmojnë se e justifikojnë plotësisht besimin që iu



është dhënë duke i emëruar në institucione të rëndësishme... nderim dhe respekt për kontributin e tyre të gjithanshëm... (Gazeta Shqip, 09.03.09)

”

Pasi lexon një shprehje të tillë të krijohet përshtypja se gratë ky “grup” shoqëror qenka në gjendje të drejtë (?!?!), madje jo vetëm kaq por ka dhënë dhe një kontribut në këtë fushë, që është një çështje meshkujsh... a thua se e drejta e meshkujve për të drejtuar është hyjnore(!!!).

Një tjetër politikan uron gratë me rastin e 8 Marsit, jo vetëm kaq por iu premtonte atyre:

“... asnjë nënë shqiptare nuk do të detyrohet ta lërë foshnjën vetëm, shteti do të krijojë mundësi që ta mbajë atë në shtëpi... (Gazeta Shekulli, 09.03.09)”

Shkrimet e përmendura më sipër në fakt vijnë në kuadrin e opinionëve dhe intervistave nga opinionistë dhe politikanë që në fakt nuk janë pjesë e medias, por që ndikojnë në përforcimin e mendimeve dhe qëndrimeve të shoqërisë që janë skeptike dhe të stereotipizuara në lidhje me pjesëmarrjen e grave në pozicione vendimmarrëse. Detyra e redaktorit në këtë rast do të ishte paraqitja e mesazhit të synuar nga autori duke “pastruar” artikullin nga stereotipat gjinorë.

28

KONKLUZIONE

Media, pushteti i katërt është një aktor i rëndësishëm në promovimin e barazisë gjinore dhe ndër partnerët kryesorë në arritjen e saj. Nëse nuk do të kishim median, si atë të shkruar dhe atë vizive, nxjerrja në pah e problemeve dhe informimi publik do të ishte tejet i vështirë. Për më tepër historia mediatike ka plot shembuj që vërtetojnë impaktin e saj në orientimin e mendimeve dhe qëndrimeve të opinionit publik. Është i vetmi pushtet, i cili hyn në mënyrë të drejtpërdrejtë në shtëpitë tona, duke na informuar rreth lajmeve dhe të rejave, problematikave dhe ndryshimeve më të fundit në vend dhe në botë.

Kontributi i saj është shumë i çmuar veçanërisht në informimin për çështjet problematike që na shqetësojnë më shumë, duke u bërë në

këtë mënyrë edhe promotori i ndryshimeve, përcuesi i fjalës së lirë. Ndryshimet në sferën e mediave kanë pësuar zhvillime drastike gjatë dy dekadave të fundit. Megjithatë ende ka vështirësi dhe problematika që duhen konsideruar nga aktorët mediatikë në mënyrën e pasqyrimit sa më të saktë, të paanuar për të plotësuar si duhet nevojën e publikut për informim.

Media e shkruar arrin të pasqyrojë që gruaja ka potencial dhe ekspertizë të mjaftueshme që mundëson përfshirjen e saj në proceset vendimarrëse e politikbërëse. Po ashtu reflektohet dukshëm që gruaja është e aftë të sigurojë dhe të përhapë informacionin e saktë dhe koherent.

Nga ç'ka reflektohet në gazetatat e monitoruara është e dukshme që gruaja e përfaqësuar ushtron presion mbi klasën politike dhe qeverisjen, duke i bërë publike problemet nëpërmjet angazhimeve të marra publikisht.

Gazetarët dhe profesionistët e medias duhet të jenë të ndërgjegjshëm për faktin se “historitë” që shesin ose që pretendojnë të bëjnë mund të formatojnë karakteristikat gjinore. Analiza tregon se media i përdor politikanet femra për të raportuar jo thjesht mbi çështje të “buta” si arsimi dhe kultura, por dhe për çështje politike dhe ekonomike me rëndësi.

Akuza, mjekët neglizhojnë nëse nuk i paguan

EGJANTËRA BASHKË

Në kërkim të rehatimit të cilave akteve, në qas e vlerësuar, mjekët në qendrën dhe nëpër klinikat e tyre dhe nëse nuk kanë marrë dhe shpërblim, kështu sikundër në kërkim të rehatimit të cilave akteve, në qendrën dhe nëpër klinikat e tyre dhe nëse nuk kanë marrë dhe shpërblim, kështu sikundër...



“Më fillim vuajtja shpesh për të abuzuar. Mjekët nuk presen të abuzuar. Dori të a thotë, oja abuzuarin ministri në spital, oja mjaft të vjetër, sepse i ka krijuar të pashprehur dhe në abuzuar nuk kam se ç’është i’-mi”, pohon Lorena Mando, duke thënë se nëna e saj vuan nga një shtetësija gastroenterologjia.

Më herë Lorena Mando duket në abuzuar në spitalin e QUP-it.

Negociatat, ministrat që ikin nga qeveria

Largohen Oketa, Gjana, Nishani e Alibeaj. Përplasje Basha-Topalli për diplomacinë

OKETA

Shkollën e kësaj lloji të rehatimit në Kosovë e ka

Borxhet, vetëvaret shpërndarësi i picave

THANË. Shkollën e kësaj lloji të rehatimit në Kosovë e ka... (text continues with details about the school and its operations)



OKETA

NE EMER TË POPULLIT

ARBEN KRISHANI

“Të gjithë dëshirojnë të shprehin... (text continues with the author's commentary)

30

Ministria Godo: Do shtojmë shëpitë ‘Mimoza’

Qeveria jep 20 mln lekë për Psikiatrikun

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Civile ka bërë të ditur se... (text continues with details of the funding and the ‘Mimoza’ initiative)



Raporti Konkurrenca, hetim tregut të bonove të thesaris

Banka e Kosovës ka bërë të ditur se... (text continues with details about the market report and the central bank's findings)



PJESËMARRJA DHE DISKRIMINIMI NË VENDIN E PUNËS

Dallimet gjinore në vendin e punës mund të përdoren si një tregues i barazisë gjinore. Gratë nuk trajtohen në mënyrë të ndershme në tregun e punës dhe përballojnë pengesa indirekte të tilla si stereotipet dhe diskriminimi gjinor.

Diskriminimi është një sjellje e dukshme me anë të së cilës njerëzit trajtohen ndryshe dhe jo në mënyrë të favorshme për shkak të racës, klasës, gjinisë apo statusit kulturor të tyre. Në terminologjinë e Konventës së Kombeve të Bashkuara “Për Eliminimin e të Gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Gruas” (CEDAW)¹⁰, konsiderohet si përjashtim, pengesë, apo dallim i bërë në bazë të seksit, që ka si qëllim apo efekt mohimin e ushtrimit të barabartë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në të gjitha fushat e përpjekjeve njerëzore. Në nenin 11 të saj, konventa specifikon detyrimet e shteteve palë në fushën e punësimit duke kërkuar që shtetet palë të marrin të gjitha masat për eliminimin e diskriminimit të gruas në fushën e punësimit.

1. Çfarë është diskriminimi gjinor në punësim?

Në një kuptim më të gjerë, diskriminimi gjinor në punë, ndodh kur një person ose grup personash trajtohen jo në mënyrë të barabartë në kontekstin e punës për shkak të përkatësisë gjinore.

- Trajtimi jo i barabartë mund të prek nivelin e pagesës, si p.sh. kur një grua paguhet me pak për një punë të njëjtë me një burrë.

¹⁰ Qeveria shqiptare e ka ratifikuar konventën në vitin 1993

➤ Diskriminimi gjinor mund të ndodhë gjithashtu edhe në terma të mundësive, si edhe të mënyrës së trajtimit në punë. Kodi i Punës në Shqipëri parashikon: ndalimin e diskriminimit, ndalimin e ngacmimit seksual, shëndetin dhe sigurimin në vendin e punës.


2. Analiza e shkrimeve

Punësimi dhe diskriminimi gjinor në punësim (siç përcaktohet në Kodin e Punës) është qartazi një çështje që ia vlen për tu diskutuar nga media.

Në këtë kontekst, kemi analizuar vetëm shkrimet që trajtojnë problemin e punësimit dhe diskriminimit të grave në vendin e punës. Qëllimi ynë është të vlerësojmë se sa e ndjeshme është media ndaj këtyre dy komponentëve së bashku. Ne vlerësojmë qëndrimin e medias ndaj barazisë gjinore. Perceptimi i përgjithshëm është se diskriminimi në media është më i madh kundrejt grave sesa burrave.


Kjo është arritur duke parë të gjithë shkrimet dhe duke gjetur subjektin kryesor të tyre. Për temën në fjalë jemi përqendruar në fjalët kyç si p.sh. punësim, abuzim seksual në punë, gra të papuna etj.

Nga studimi rezulton se numri i shkrimeve që trajton këto çështje në të tre gazetetat është 45 respektivisht.



Grafiku nr. 9 Numri total i shkrimeve

Vihet re një shpërndarje jo konstante e shkrimeve në të tre muajt e marrë në studim.



Grafiku Nr. 10. Shpërndarja e shkrimeve

Sikurse shihet dhe nga grafiku shumica e shkrimeve i përkasin muajit Mars. Kjo lidhet me aktivitetet që kryhen në ditën e festës së 8 Marsit dhe pasqyrimin të deklaratave apo premtimeve të bëra nga politikanë të ndryshëm në mbrojtje të interesave të grave.

Arsyeja tjetër përkon me kohën e diskutimit nga media dhe opinioni publik të skandalit të publikuar përmes një video të ish-Ministrit të Kulturës dhe një vajze, e cila aplikonte në ministri për punë.

Ajo që bie në sy është ndërthurja e të dy ngjarjeve në interes të paraqitjes së fenomeneve siç është ai i skandalit seksual dhe jo të trajtimit të punësimit, apo gjithëpërfshirës në çështjet themelore që shqetësojnë gratë.

Psh. Gazeta Panorama citon pjesë nga fjala e mbajtur nga këshilltarja e Kryeministrit në ditën e 8 Marsit, që fokusohen në skandalin seksual të ish-Ministrit.

- ✓ *Gazeta Panorama: Skandali seksual*
- ✓ *Guxholli: Fenomeni “Pango” do të shpërthente njëherë*

...Duke folur në Ditën Ndërkombëtare të Gruas, këshilltarja e Kreut të Qeverisë, theksoi se si fenomen negativ ai do të shpërthente një ditë. “Imazhi i femrës shqiptare, nuk është një imazh i ngritur apo i prishur nga një individ apo ngjarje e rastit. Në çdo shoqëri ka fenomene negative të cilat here pas here shpërthejnë”, theksoi Guxholli.

Është pikërisht po kjo gazetë “Gazeta Panorama” që vë përball fakteve të skandalit një intervistë të bërë për ditën ndërkombëtare të gruas me ish-Ministrin të titulluar: “Këndvështrimi mbi gruan”.

...Nga intervista: thuhet... Shekulli 21 është shekulli i grave...

...Të shohim. Unë në ministri kam rreth 80 % të punonjësve femra

Dhe me pas vijon me komentet në lidhje me faktet e mësipërme.

“...Fakti që në ministrinë, në krye të së cilës deri pak ditë më parë qëndronte, kishte në përbërje të saj 80% femra dhe vetëm 20% burra, nuk nënkupton se Pango është luftëtar i paepur i të drejtave të grave, aspak si një revolucionar feminist që kërkon praninë e tyre me shumë sesa në masën 30%. Mund të jetë dhe thjesht një rastësi. Por fundja le ta quajmë një vlerë të një institucioni, qoftë edhe të paqëllimtë, në favor të gruas që shpesh e gjen veten në pozicione të diskriminuara...” ”

Çështjet kryesore të trajtuara në analizën e shkrimeve të monitoruara

I. Fushat e pasqyruara

Fushat e pasqyruara reflektohen në përmbajtjen e shkrimeve të gazetave që janë fajtorë në mos reflektimin e ngjarjeve, ashtu edhe për mënyrën se si pasqyrohen ngjarjet. Pyetjet që ngrihen janë: Çfarë përbën specifikisht një çështje e grave? dhe A ka arritur media të pasqyrojë këto çështje?

Megjithëse ka përjasje të ndryshme në lidhje me trajtimin e grave në tregun e punës, analiza e shkrimeve të zgjedhur dhe monitoruar, tregon se diskriminimi ndaj gruas vazhdon të jetë në një shkallë të lartë sot në Shqipëri.

Një tregues i rëndësishëm i imazhit të grave në media është subjekti me të cilin ato shoqërohen në lajme. Rezultatet e monitorimit tregojnë se nga 45 artikuj pjesa më e madhe, afërsisht 50% i referohen çështjes së ngacmimit seksual në punë. Sikurse shihet dhe nga grafiku gratë janë të mbiprezantuara me lajmin e ngacmimit seksual. Kjo do të thotë që ngjarjet në dimensionin “gjinor”, shpesh cilësojnë aktorët femra kur bëhet fjalë për ngacmimin seksual sesa kur merren me subjekte të tjera.

Ashtu sikurse thuhet edhe në një artikull të gazetës Panorama¹¹ është pikërisht momenti i shpërthimit të fenomeneve negative që bën shoqërinë të mendojë dhe për një reagim më ligjor dhe më formal ndaj këtyre fenomeneve. Sikurse shihet edhe nga grafiku, media ashtu sikurse dhe vetë opinioni publik në rastet e shfaqjes flagrante të këtyre fenomeneve.

¹¹ Gazeta Panorama “skandali seksual”

Rezultate


22 artikuj të fokusuar rreth skandalit seksual ¹²

4 artikuj reflektojnë politika për punësimin ku përfshihen dhe gratë

4 artikuj pasqyrojnë raste të abuzimit me detyrën (nga gratë)

4 artikuj pasqyrojnë dhunë fizike ndaj grave

11 artikuj fokusohen në raste të tjera



Grafiku Nr. 1 | Shpërndarja sipas fokusit të artikujve

2. Individualiteti i shkrimeve

Në përgjithësi ka shkrime që janë individualiste në natyrë dhe që fokusohen në ngjarje të veçanta. Por ka edhe shkrime që bazohen në të njëjtat fakte dhe ngjarje, siç është rasti i shkrimeve të tre gazetave të monitoruara që komentojnë investigimin e “Fiks Fare” për ish-Ministrin e Kulturës, të gazetës Shekulli, Panorama dhe Gazeta Shqiptare që raportojnë mbi dhunimin e një shitëseje në vendin e saj të punës nga një adoleshent i papërgjegjshëm apo informimi i publikut

¹² Artikujt i referohen komenteve dhe diskutimeve në lidhje me skandalin seksual të investiguar nga emisioni “Fiks Fare”

për ofrimin e kurseve dhe punësimit nga Bashkia e Tiranës për 50 gra të papuna nga gazetaret Shqiptare dhe Panorama.

3. Punësimi dhe përfshirja e grave

Është fakt që punësimi është një problem në Shqipëri. Niveli i të papunëve është i lartë, pavarësisht programeve të nxitjes së punësimit të ndërmarra nga zyrat e punësimit. Të dhënat e INSTAT tregojnë se gratë janë më të afektuara nga papunësia. Rreth 21% e grave të afta për punë, janë të papuna. Por, megjithëse është një nga problemet që duhet diskutuar.

Jo e paparashikuar, rezultatet e monitorimit tregojnë se shumë prej shkrimeve trajtojnë çështjen e punësimit, por pa u ndalur te çështja gjinore. Punësimi trajtohet si një çështje sociale, pa bërë dallime mbi ndryshimet gjinore në vendin e punës dhe efektet që mund të sjellin zhvillime të ndryshme politike, ekonomike dhe sociale në aspektin gjinor.

Nga 45 artikuj të monitoruar, 23 artikuj prezantojnë fushën e punësimit, nga të cilat vetëm 30% prezantojnë në mënyrë direkte punësimin e grave. Këto përqindje modelojnë figurën e shoqërisë sonë, ku punësimi i grave nuk ka rëndësi shumë të madhe. Edhe nëse ndryshimi në përqindje për dy gjinitë është relativisht i vogël, fakti që sjellja e grave ndaj angazhimit në jetën sociale dhe ekonomike, shprehjes së shqetësimit ndaj gjetjes dhe mbajtjes së një pune, avancimit në karrierë, mungon në gazetaret tona, çon në konkluzionin se në këtë aspekt diskriminimi vepron kundër femrave.

Kështu, nga 12 shkrime të publikuar nga gazeta Shqip, rezulton që pesë prej tyre (41%) trajtojnë probleme të ndryshme të punësimit dhe diskriminimit, por pa u ndalur në problemet e përkatësisë gjinore.

o **Gazeta Shqip:**

1. Gjysma e punonjësve pa konkurim
2. KSHH trajton 1000 ankesa në vit
3. Të shfuqizohet urdhri për kontratat e punës
4. Puna e zezë rrezikon pensionet
5. Aksidentet në punë të reduktohen me 15%

Në një nga shkrimet e monitoruar të botuar nga gazeta Shqiptare titulli të krijon përshtypjen se artikulli do të bëjë një analizë të papunësisë në Shqipëri. *Shqiptarët: problemi i parë, papunësia*. Në të vërtetë, artikulli i referohet të dhënave të anketës të kryer nga Zogby, ku rezulton që papunësia është përmendur si problem kryesor nga 67% e shqiptarëve.

Nga monitorimi i artikujve të gazetës Shqiptare rezulton se, nga 14 artikuj të monitoruar, gratë prezantojnë rolet e tyre vetëm në 4 artikuj ose në 30% të rasteve. Pjesa tjetër i referohet komenteve lidhur me “skandalin seksual” dhe informacioneve të caktuara në lidhje me nivelin e punësimit/papunësisë¹³. Kjo mund të ilustruhet me shembujt e mëposhtëm:

o **Gazeta Shqiptare:**

1. Problemi i parë papunësia
2. Lokalet: Gjatë vitit të kaluar u ul numri i të papunëve

Duke vijuar më të njëjtin arsyetim, për gazetën Shekulli mund të citojmë artikujt e mëposhtëm:

o **Gazeta Shqiptare:**


1. Risitë që sjell kontrata e spitaleve

¹³ Nuk përmendim artikujt që lidhen me skandalin seksual.

2. Siguria dhe shëndeti në punë

Gratë hasin ende diskriminim në të dyja format e veçimit – horizontal dhe vertikal. Shumica e tyre vazhdojnë të jenë të punësuar në sektorë, ku tradicionalisht punojnë gra, si shëndetësia dhe arsimi. Një masë e rëndësishme për përmirësimin e gjendjes së gruas është ekzistenca e punëve të cilësisë së mirë për gratë, në pozicione manaxheriale apo nivele të larta drejtimi, me norma më të larta pjesëmarrjeje. Gratë ende përfaqësojnë një minoritet të dallueshëm në të tilla pozicione në të gjithë botën duke mbajtur vetëm 28.3 % të këtyre punëve të rëndësishme.¹⁴ Në BE gratë e kanë rritur pjesën e tyre në pozicionet e nivelit të lartë gjatë dekadës së kaluar me 3.1 %, duke arritur në nivelin aktual të 30.6%.

Megjithatë, nga analiza e artikujve, rezulton se gazetat i referohen në mënyrë direkte më shumë grave të punësuar në administratën publike, përkatësisht 10 artikuj, biznes dhe shoqërisë civile (7 artikuj) dhe shëndetësi (5 artikuj).



Grafiku nr. 12 . Shpërndarja sipas sektorëve

¹⁴ Barazia në punë: Të prekësh sfidat. Raport në kuadrin e vazhdimin të deklaratës së ILO-s “Mbi parimet dhe të drejtat themelore në punë”, Konf. Ndërkombëtare e Punës. Viti 2007

Analiza e modeleve të intervistuar jep informacion mbi shkallën e pohimit nga vetë gratë të raportuar nga gazeta. Kjo na lejon të verifikojmë nëse gratë flasin vetë rreth vetes së tyre apo të tjerët flasin për to. Ky është një faktor i rëndësishëm në imazhin e grave që komunikohet përmes medias.

Nga monitorimi rezulton se në gazetatat aktuale shfaqen dhe rishfaqen vetëm 6 gra në rolet e tyre në pozicione drejtuese (ose 14 % e artikujve). Një pjesë e tyre pasqyrojnë intervista të dhëna nga drejtues femra për çështje të ndryshme që lidhen me punësimin dhe të ardhurat. Këta artikuj janë të shoqëruar edhe me fotot e tyre.



Në një artikull të gazetës Shqiptare dhe dy prej shkrimeve të gazetës Shekulli (20% e shkrimeve) jepet imazhi i dy drejtueseve femra, përkatësisht të ISKSH dhe QSUT që flasin për skemën e sigurimeve të kujdesit shëndetësor. Jo vetëm imazhi i drejtueseve femra, por edhe fakti që gratë janë të përqëndruara në punë që lidhen me shëndetin dhe

arsimin, le të kuptosh që vetë shkrimet në mënyrë indirekte marrin në konsideratë probleme që lidhen me çështjet gjinore.

“ ..Sipas Gjeorgjina Kulit, drejtoreshë e QSUT-së, kjo do të ndikojë shumë në shpërblimin e personelit shëndetësor, madje dhe në rishikimin e pagave të tyre.

“Punonjësit do të marrin një pjesë të të ardhurave dytësore të spitalit dhe do të kenë stimul për të sistemuar konsultat dhe nga ana tjetër do të ketë paga më të larta...¹⁵”

Problemi i punësimit trajtohet edhe në artikullin e botuar nga gazeta

¹⁵ Gazeta Shekulli.

- ✓ Shekulli “*Ushtaraku, infermiereve nuk u lidhen kontratat e punës*”

Infermierët e spitalit ushtarak po jetojnë me frikën se shumë shpejt do të lenë vendet e punës. Shkak për këtë janë bërë kontratat e punës, ku drejtorja e këtij spitali ka vendosur të lidh me një pjesë të tyre kontrata 3-mujore dhe 6-mujore. “Kemi shkuar në drejtori për të marrë një shkresë se përse nuk është lidhur kontrata 1-vjeçare dhe shefi i personelit përgjigjet se kështu - tha drejtori, por nuk na është thënë asgjë me shkrim” - pohon infermierja Alma Kalici.

Në përgjithësi pagesa për punët e kryera tradicionalisht nga femrat si p.sh.- asistente administrate, infermiere, bibliotekare, mësuese-mbeten më të ulta krahasuar me ato të kryera tradicionalisht nga burrat si p.sh. inxhinierë ose gjykatës.

Vitet e fundit, situata dhe pozita sociale e gruas në Shqipëri ka ndryshuar. Megjithatë akoma ka diferenca të theksuara në barazinë dhe mundësitë që iu ofrohen burrave dhe grave në punësim. Mundësitë ekonomike dhe për të bërë karrierë për gratë janë akoma të kufizuara. Sot, në Shqipëri, është shumë e vështirë për gratë të gjejnë dhe mbajnë një punë, të jenë të mbrojtura nga dhunimet fizike dhe morale të ambientit që na rrethon.

3.1 Gruaja në pozicione drejtuese

Gratë hasin vështirësi në arritjen e pozicioneve drejtuese. Sipas raportit të EC mbi barazinë midis burrave dhe grave, theksohet se prezenca e grave menaxhere në kompani po përparon shumë ngadalë dhe ka mbetur në nivelin 33%. Shkrime të tilla si: “*Sikur bizneset të drejtohen nga gratë*¹⁶” ndihmojnë në largimin e stereotipeve, vlerësimin e gruas dhe nxitjen e barazisë gjinore.

¹⁶ Gazeta Shqip

Në sektorin privat drejtimi i bizneseve nga gratë është në nivele të ulëta. Sipas statistikave të INSTAT, vetëm 17% e drejtuesve të biznesit privat janë gra dhe vajza, ku numri më i madh i tyre është i përqëndruar në zonat urbane 85% dhe më pak në zonat rurale me 15%. Një përfaqësim kaq i ulët është i kushtëzuar nga shumë faktorë socio- kulturorë, por edhe nga ndikimi i ulët i institucioneve shtetërore dhe financiare, të cilat nuk i krijojnë mundësi apo mbështetjen e duhur favorizimit të sipërmarrjes së biznesit nga gratë dhe vajzat.¹⁷

“...Studimi i bërë në Harvard tregoi se rendimentet profesionale të grave janë më të mira se ato të kolegëve meshkuj. Në fakt bankat e vetme që nuk janë përfshirë në krizën e kredive, janë ato që kanë gra në pozicione drejtuese, shpjegon Heather McGregor, një specialist finance në bankën “City” në Londër.¹⁸”

“Gratë kanë një raport më racional me paratë, më pak emotivë dhe janë më shumë të prirura ndaj kursimeve. Ky është përfundimi që ka arritur qeveria islandeze, e cila në krye të dy bankave më të mëdha në vend, ka vendosur dy gra.¹⁹”

42

Lind pyetja: A është media e ndjeshme ndaj kësaj çështje, apo më shumë kur këto raste përdoren për forcimin apo dëmtimin e imazheve politikbërësish? Ajo që vihet re, megjithëse flitet dhe diskutohet shumë për çështjet e punësimit dhe diskriminimit të grave në Shqipëri, media është vetëm në rastet e evidentimit të rasteve flagrante, ku një drejtues i lartë abuzon me detyrën siç është rasti i Ministrisë të Kulturës.

¹⁷ “Përfaqësimi dhe Cilësia e Demokracisë në Shqipëri-një perspektivë gjinore” Qendra e Aleancës gjinore për zhvillim, 2006 :33

¹⁸ Gazeta Shqip “Sikur bizneset të drejtohen nga gratë”

¹⁹ Gazeta Shqip “Sikur bizneset të drejtohen nga gratë”

3.2 Diskriminimi në pagë

Nga studimet e ndryshme rezulton se ka pabarazi në pagesën midis grave dhe burrave për punë të barabartë. Ndryshimet në të ardhurat, vijne për arsye të ndryshme: (Eitzen, 2000)

1. Gratë punojnë kryesisht në poste pune me pagë të ulët
2. Gratë hyjnë në forcën e punës me nivele më të ulta page se burrat
3. Gratë kanë më pak eksperience dhe arsimim se burrat
4. Gratë kanë tendencë të punojnë më pak jashtë orarit sesa burrat.

Këto konkluzione e shpjegojnë pjesërisht problemin, pasi ato nuk analizojnë faktorët e pagesës jo të barabartë të burrave dhe grave për nivel të njëjtë arsimimi dhe eksperience. Po si e trajton media këtë problem? Media, shpesh bëhet pjesë e problemit dhe jo e zgjidhjes. *Gazeta Shqiptare: Pango, pagesa shtesë për sekretaret dhe asistentet*

“ ...”U janë dhënë orë jashtë kohës normale të punës asistentëve të ministrit, sekretareve, duke respektuar limitin e përcaktuar, por nuk janë mbajtur kohëshënuesit, si dhe të shpjegohej arsyeja se përse kanë punuar” thuhet në raportin e KLSH... ”

Në këtë artikull ne mund të adresojmë një pyetje shumë të thjeshtë: Eshtë punësimi jashtë orarit një çështje reale për shoqërinë sot? Duket se vetë media mban qëndrim jo realist dhe diskriminues ndaj çështjes së grave, duke paraqitur fakte që rëndojnë mbi gratë pavarësisht në ndeshin ose jo rëndom në shoqërinë tonë.

4. Gratë e padukshme

Përveç shfaqjes në një numër tepër të kufizuar rolesh, gratë shpesh mungojnë në media. Atyre shpesh u faturohen ngjarje të dhimbshme, sesa jepen zgjidhje apo kërkohet mendimi i tyre për ndryshimin e rolit të tyre në shoqëri. Ndërsa disa grupe grash janë tepër të

identifikuara në media si psh gra të veja që dhunohen fizikisht ndërsa punojnë për të mbajtur fëmijët e tyre. Grupe të tjera grash si psh gratë e moshuara, ose gratë nga minoritetet dhe grupet fetare, klasës punëtore i kushtohet pak ose aspak vëmendje.

✓ *Gazeta Shekulli:*

“...39 vjeçarja Valbona Hasankasa punonte shitëse në një dyqan veshjesh në lagjen nr.13 në zonën e plazhit. Të dielën një adoleshent u paraqit në vendin e saj të punës dhe kërkoi për të blerë kapuç të zi. Gruaja refuzoi kërkesën, si dhe nuk pranoi ti jepte klientit të ri numrin e pronarit të dyqanit ku punonte. Më pas djaloshi 16-vjeçar e qëlloi me thikë në fytyrë dhe në trup, e pasi vodhi veshje dhe para në dyqan e la gruan në pellgun e gjakut dhe u largua. Shitësja u gjet nga klientë të rastësishëm dhe më pas u dërgua në spital...”

5. Këndvështrimi nga tregohet historia

Kur gratë prezantohen në media, ato tentojnë të portretizohen në mënyra që janë jo të merituar dhe të pasakta. Ato shpesh tregohen si viktima të dhunës fizike dhe psikologjike. Megjithëse stereotipet e grave si persona që kujdesen për familjen kanë më tepër tone positive, ato mbeten stereotipe që nuk reflektojnë aspirate dhe eksperiencat komplekse të grave.

✓ *Gazeta “Shekulli”*

“...Parajsa (e paguar me paratë e shtetit) që ministria i premtonte vajzës së re në këmbim të vendit të punës, përmbledhej në tre premtime kryesore: Do të kesh rrogë të mirë”. Do të bësh udhëtime jashtë shtetit”. “Do fitosh miliona nga projektet”...”

Media thekson më poshtë se bëhet fjalë për shitje posti. Ai e largon vëmendjen nga vajza...dhe i drejtohet falsitetit moral të shoqërisë dhe administratës që ajo mban mbi shpinë...

6. Dhuna ndaj grave në vendin e punës

Nuk raportohet se në përgjithësi shikohet si një ngjarje që ndodh në jetën private, ose raportohet në mënyra sensacionale, që shpesh vënë në dyshim dhe fajësojnë viktimën.

Historitë me abuzime shpesh nënkuptojnë që gratë e “kërkuan të ndodhte” nëpërmjet referencave të tilla si “ajo ishte gjysëm e zhveshur, etj. Në këtë mënyrë media në mënyrë indirekte mbështet fajësimin e grave për nxitjen e ngacmimit seksual, duke tërhequr vëmendjen nga detyrimet e punëdhënësit për të marrë masa që të parandalojë fenomenin.

✓ *Gazeta Shqip*

Dy grabitës me motor, plumb pronares së një dyqani valutor.

Një 46 vjeçare është plagosur me armë zjarri në afërsi të një pike të këmbimit valutor, në Tiranë...

“...Sipas policisë, ka dyshime se autorët mund ta kenë ndjekur të plagosurën edhe për ndonjë motiv tjetër, pasi jo shumë larg vendit të krimit, ndodhej edhe një argjendari, e cila nuk është prekur nga grabitësit...”

7. Korrupsioni dhe integrimi gjinor

Korrupsioni është në të vërtetë pa kufij. Megjithatë statistikat tregojnë se gratë janë më pak të korruptuara se burrat dhe shpesh vuajnë pasojat e korrupsionit. Në një shoqëri maskiliste ku jetojmë, çështjet e korrupsionit trajtohen nga këndvështrimi i burrave. Media është vigjilente ndaj prezantimit të rasteve të korrupsionit, pa i kushtuar rëndësi rolit të zhvillimeve gjinore në luftën kundër tij. Megjithatë, nga analiza e shkrimeve të monitoruar, në kundërshtim me ç’ka pritej, 4 shkrime i referohen grave që akuzohen për abuzim me detyrën.

- ✓ *Gazeta Shqip: Sherri për postin, mbyllet qendra për fëmijët e ngujuar.*

Kryebashkiaku i Poliçanit ngre dyshime për abuzime me fondet.

Ish-drejtoresha thërret prindërit të marrin fëmijët: “Ata ishin në besën time, jo të shtetit”

- ✓ *Gazeta Shqip “Drejtorja e Qendrës spitalore “Nënë Tereza” shkarkoi nga detyra mjeken Vigjilenca Demiraj”.*

“...Ndërkohë që priten edhe përfundimet e Komisionit Kombëtar të Gjykimit Profesional dhe Disiplinor, të cilët mund të shkojnë deri në heqjen e së drejtës së ushtrimit të profesionit për tre vjet, duke mos e lejuar të punojë si mjek në asnjë institucion shëndetësor apo privat.”

Një muaj më parë në emisionin “Fiks Fare” u denoncua mjekja Vigjilenca Demiraj, e cila për një vulë në epikrizë i kërkon 2000 lekë Dile Islamit nga Kurbini. Kjo mjekje do t’i vinte vetëm një vulë në epikrizën e pacientit, i cili vuan nga ceroza hepatite. Ky pacient është invalid i kategorisë së parë dhe si i tillë përfiton shumë shërbime falas në spital, ku ka qenë i shtruar disa herë.

KONKLUZIONE

Impakti i madh social i medias njihet gjerësisht dhe roli i tij në parandalimin dhe përforcimin e diskriminimit është e një rëndësie të madhe.

Nëse gazetatat e marrin seriozisht çështjen e trajtimit të barazisë gjinore, duke përfshirë edhe barazinë gjinore në punësim, ato duhet të shkojnë më tej nga ajo ç’ka bëjnë tani. Nuk është e mjaftueshme të lesh një hapësirë të vogël të fokusuar mbi gratë. Sfida qëndron në faktin se si të prezantohen ngjarjet, titujt, çfarë ato pasqyrojnë dhe mënyra e analizimit të fenomeneve.

Thuhet se media është thjesht një pasqyrë e shoqërisë. Nëse burrat janë në pozicione vendimmarrëse, punëmarrës apo kontrollues të hallkave të vlerësimit, atëherë kjo është ajo që duhet të reflektohet në media. Vetë shoqëria duhet t'i drejtohet medias: çfarë keni bërë, për t'iu dhënë zë të pazëshmëve? Është e vërtetë që gratë janë vetëm objekte bukuri apo viktime të dhunës?

Meqenëse media sjell në vëmendjen e opinionit publik çështje të ndryshme dhe reflekton atë ç'ka publiku e konsideron më të rëndësishme, ajo mund të ketë influencë në forcimin e opinionit publik dhe politikbërësve për sektorë të ndryshëm, duke përfshirë edhe punësimin. Në këtë mënyrë gratë mund të jenë pjesëmarrëse aktive duke gëzuar të drejta të barabarta përfaqësimi, si një parim bazë i një shoqërie demokratike.

Pushteti që media ka nëpërmjet impaktit të menjëhershëm të informacionit që ajo transmeton dhe shtrirjes gjeografike të saj është i padiskutueshëm. Por gazetarët, redaktorët, drejtuesit e informacioneve nuk duhet të harrojnë këtë mision fisnik që kanë të informojnë publikun dhe të jenë të ndërgjegjshëm për ndikimin që ka çdo fjalë, çdo mesazh dhe çdo pamje që ata transmetojnë në formësimin e mendimit të opinionit publik. Për këtë arsye një herë më shumë media duhet ti kthehet misionit të saj, informimit duke respektuar diferencat mes grupeve të shoqërisë dhe duke pasqyruar realitetin e informacionit të zhveshur nga stereotipet, paragjykimet dhe diskriminimet.

Ministria e Financave, në pritje

Kriza e ...
Sondazhi, 73.4% pro grave në politikë
nga dikasteri i Shëndetësisë
ve, zgjidhja
e të ministres Godo

**Berisha: I kujtoj Ina
Ramës Kodin e Vdekjes**

Grarishit

**Partitë dhe KQZ shkelin
ligjin e barazisë**

Stone: Arritje, më shumë gra në Kuvend
"30 për qind përfaqësim është kuota më e lartë që kam parë"

ANALIZA GJUHESORE NE MEDIA

I. Analiza e diskursit të medias

Mënyra e paraqitjes së formave të përjashtimit, e të diskriminimit social, si dhe format e dhunës e të keqtrajtimit mund të trajtohen në kuadër të teorive dhe të perspektivave të ndryshme, të cilat merren me trajtimin e problemeve të ndryshme të shoqërisë, duke u përpjekur që t'u japin një përgjigje. Studimet për median kanë pasur kryesisht në fokus mënyrën sesi media ndikon dhe ndikohet prej marrëdhënieve të pushtetit brenda sistemit shoqëror, duke përfshirë këtu marrëdhëniet mes klasave, gjinive, etnive, si dhe mes grupeve të veçanta si p.sh mes politikanëve dhe popullit.

Sipas Fairclough-it (1995; 27), gjuhësia kritike e vë, gjithashtu, theksin në rolin e përzgjedhjes së fjalorit të përdorur në proceset e kategorizimit. Për shembull, “studimi i diskriminimit gjinor në raportimin në media mund të marrë në shqyrtim mënyrën sesi ndryshimet në fjalorin e përdorur për t’iu referuar meshkujve dhe femrave i drejton njerëzit drejt sistemeve kategorizuese që ekzistojnë më parë, të cilat janë të një karakteri të fuqishëm ideologjik’.

2. Zgjedhja e leksikut

Gratë përfaqësojnë në politikë jo vetëm gratë, por të gjithë votuesit e tyre. Media i emërton shpesh duke i dhënë përparësi gjinisë së tyre ndaj statusit të tyre profesional. Megjithatë gratë në jetën politike mund të duan të emërtojnë veten e tyre dhe kjo më pas pasqyrohet në media. Fowler e konsideron këtë si një simptomë të një praktike

të gjerë, ku koncepti i 'grave si një grup' shprehet në diskurs (1991:103). Përdorimi në tekstet e medias shërben për të natyralizuar dhe riprodhuar identitete normative gjinore.

Megjithatë, pavarësisht kodeve të përshtatura nga gratë në jetën publike, ato priren të paraqiten si “femra” duke treguar se ato janë gra në një mjedis të dominuar nga burrat. Kjo gjë është e dukshme dhe në nivele më të gjera, ku gratë konsiderohen si një grup i cili e ka të nevojshëm “mbrojtjen” nga burrat ose mbështetjen e tyre. Pavarësisht se shpesh deklarata të tilla janë bërë në kuadrin e një fushate parazgjedhore, ku pjesëmarrja e gruas në politikë konsiderohet si detyrim, sërish vlerësimi i grave shihet më shumë si një favor që burrat po u bëjnë atyre.

“ Të mbrojmë femrat nga zyrtarë si Pango. (Shqip, 09.03.2009)
Ndoka: **Gratë** emancipojnë politikën. (Panorama, 10.03.2009)
Meta: Politika punësimi **për gratë**. (Panorama, 18.03.2009) ”

50

Prirja mes vetë grave është të diskutojë performancën e roleve të tyre publike dhe profesionale në terma që duken të menduar për të vënë theksin në natyrën plotësuese të identiteteve të tyre private dhe publike.

“ Jozefina Topalli, **mamie** në një ditë në maternitetin e Fierit. (Panorama, 18.01.2009) ”

Faludi (1992) argumenton se media e vë fokusin në marrëdhëniet e tyre familjare.

“ Nuk ka gjë më të bukur në jetën e një **nëne** se momenti kur lind fëmija. (Panorama, 18.01.2009) ”

Fairclough (1995: 102) vëren se “asociacionet janë shpesh një vend i mirë për të parë për kontradikta në tekste”. Përfaqësimi i grave në media në sytë e publikut shpesh përfshin përdorime të formave të

rasës gjinore, duke treguar kështu përkatësinë e tyre apo të procesit në të cilin ato përfshihen tek një person i caktuar, si në rastin e mëposhtëm:

✓ “Rekrutimet” perverse të **Pangos** (Shqip, 5.03.2009)

Tendenca për të seksualizuar identitetet e grave është gjithashtu e dukshme në radhët e shtypit shqiptar, ku për të trajtuar një skandal seksual të kabinetit qeveritar, nuk mungojnë dhe mekanizma të tillë si metonimia:

✓ Engjëjt e **mbërtheckave** (Panorama, 16.03.2009)

Fairclough (1995) argumenton se një nga funksionet e diskursit të medias është që të jetë ndërmjetës mes llojeve të diskursit të sferës publike dhe diskursit të lexuesve. Në rastin e gjinisë së intervistës së medias, kjo zakonisht rezulton në prodhimin e teksteve hibride të cilat theksojnë identitet publikë dhe privatë të figurave publike. Kur gratë në jetën publike jepen në media ka një mungesë relative të referencave të roleve të tyre në sferën publike dhe një fokus joproporcional në identitetet e sferës së tyre private.

“ Për djalin çfarëdo që të kem jam e predispozuar në çdo kohë. (Panorama, 08.02.2009)

Drejtoresha: Tani ndihemi në presion, **kemi familje**
(Gazeta Shqiptare, 07.03.2009) ”

3. Emërtimet në media

Mediat nuk janë të detyruara të pranojnë titujt me të cilët femrat vetëmëtohen në sytë e publikut. Nga ana tjetër, titujt dhe emërtimet që zgjidhen nga media mund të shprehin kuptime të ndryshme, duke përfshirë dhe distancën ideologjike me individët e paraqitur. Për shembull, përdorimi i titujve akademikë që kanë femrat (*Prof., Dr., etj*), apo i titujve si: *zonja, zonjusha, etj*, janë më formalë dhe tregojnë respekt.

Një formë respekti ndaj institucionit që përfaqësojnë është dhe përdorimi i emërtimeve duke u bazuar në funksionet që kryejnë. Emërtime të tilla, si: *kryeparlamentarja, kryetarja e grupit parlamentar, ministrja* etj., përdoren jo rrallë jo vetëm në artikujt e shkruar, por dhe si titujt kryesorë në median e shkruar:

- ✓ **Kryeparlamentarja:** *Ne do të zbatojmë ligjin (Shqip, 14.02.2009)*
- ✓ **Ministrja** Bregu: *Vendi ynë, surprizë në krizën botërore (Shqip, 22.02.2009)*
- ✓ **Drejtoresha** e ISKSH-së, *Hana thekson se risitë fillojnë me rritjen e shkallës së autonomisë (Shekulli, 26.03.2009)*

Përdorimi i mbiemrave të personave tregon një referim standard, i cili përdoret me synime të ndryshme. Përdorimi i mbiemrave mund të tregojë afërsi ndaj personit, por edhe mungesë respekti. Në të përditshmet shqiptare, për femrat në politikë ose në karrierë, vihet re një përdorim i dendur i mbiemrave të tyre. Ky përdorim nuk ka nuanca negative, sepse duke qenë një vend i vogël, përdorimi i mbiemrave të personave të njohur duket të jetë i mjaftueshëm për lexuesit për të kuptuar se për cilin person publik bëhet fjalë.

- ✓ **Topalli:** *Hyrja në Nato, një ndër momentet më të bukura (Panorama, 20.02.2009)*
- ✓ **Meksi:** *Qeveria të mos fshehtë krizën, rritja dyshifrore është gënjeshtër (Gazeta Shqiptare, 21.02.2002)*
- ✓ **Shamku:** *Po lëshohen kartonëfotokopje, jo diploma të rregullta. (Shqip, 26.01.09)*
- ✓ **Kuli:** *Do të rriten shpërblimet dhe kërkesat e llogarisë (Shekulli, 29.03.2009)*

Kjo duket të jetë një dukuri neutrale, sepse nga materialet e analizuara vihet re se përdorimi i mbiemrave të personave publikë është një dukuri që përdoret gjerësisht dhe për meshkujt në politikë apo në funksione drejtuese.

- ✓ **Mediu:** Ina Rama vepron politikisht (Gazeta shqiptare, 13.02.2009)
- ✓ **Meta:** Politika punësimi për gratë (Panorama, 18.03.2009)
- ✓ **Berisha:** Gabimet e Ina Ramës (Shqip, 8.02.2009)

Një mekanizëm tjetër që përdoret shpesh në media për t'iu referuar femrave në karrierë është dhe përdorimi i plotë i emrit dhe i mbiemrit të tyre. Një formë e tillë referuese mund të përdoret për të dalluar mes personave publikë që kanë mbiemra të njëjtë, si në rastet e mëposhtme ku emri i gruas së parë të vendit jepet i plotë që publiku të mos mendojë se flitet për Presidentin e Republikës, apo në rastin e Prokurores së Përgjithshme, e cila ka mbiemër të njëjtë me një figurë tjetër publike.

- ✓ **Ina Rama**, kritika në Sarandë (Panorama, 15.03.2009)
- ✓ **Teuta Topi:** Pango, shpërdorim vlerash (Gazeta Shqiptare, 9.03.2009)

Megjithëse, në tërësi përdorimi i emrave dhe i mbiemrave të figurave publike është një dukuri neutrale, nuk mungojnë dhe rastet kur përdorimi i emrit apo i mbiemrit tregon mungesë respekti. Në thelb, kjo mungesë respekti nuk është ndaj figurës së femrës, por ndaj mënyrës sesi ushtrohet një funksion i caktuar drejtues. Në përdorime të tilla ka një përshkallëzim të negativitetit, ku në nivelin më të lartë shfaqet në rastet e përdorimit vetëm të emrit të përveçëm.

- ✓ Sekti **Topalli** rrezikon fitoren e PD-së në zgjedhje (Panorama, 14.03.2009)
- ✓ Kuvend, **Jozefina Topalli** boton revistë për veten (Shekulli, 6.02.2009)
- ✓ *Viktimat e vërteta të Jozefinës* (Panorama, 16.02.2009)

Referimet ndaj femrave, duke u bazuar në funksionet që ato kanë, përdoren jo vetëm në botën e politikës dhe në sferën publike, por dhe në paraqitjen në media të femrave në nivele të ndryshme të

shoqërisë. Nëse në sferën publike, referimi tek femrat në karrierë, i bazuar në pozicionet që ato kanë është tregues i respektit ndaj tyre, në jetën e përditshme, përdorimi i këtyre emërtimeve ka një funksion tjetër. Në analizën e lajmeve në media për krime ndaj grave, shpesh nxirret në plan të parë profesioni i tyre. Ashtu sikurse thekson dhe Clark (1992), përmes këtyre emërtimeve tregohet pafajësia e femrave. Nga të dhënat e analizuara, del në pah se në rastet e akteve të dhunës të kryera ndaj femrave, për të mëshuar në fajin e autorit të aktit, në vend të emërtimeve të viktimës mbi bazën e moshës, përzgjidhen emërtime në bazë të profesionit apo statusit social. Kjo gjë duket qartë në shembujt e mëposhtëm:

- ✓ *Thikë në qafë **shitëses** për ta grabitur (Panorama, 9.03.2009)*
- ✓ *Dy grabitës me motor, plumb **pronares** së një dyqani valutor (Shqip, 19.02.2009)*
- ✓ *Horror, minoreni i pret fytyrën **shitëses** (Gazeta shqiptare, 09.03.2009)*

54

Në raste të veçanta, në varësi të kontekstit, emërtimi në bazë të profesionit mund të shoqërohet dhe me nuanca negative, si në rastin e mëposhtëm ku përmendja e profesionit ‘asistente’ dhe ‘sekretare’, ndonëse i referon në realitet vërtet kësaj kategorie punonjësish të një institucioni të caktuar, në kuadrin e një skandali seksual, krijon përshtypjen se kanë përfituar prej marrëdhënieve me drejtuesin e tyre.

- ✓ *Pango, pagesa shtesë për **sekretaret** dhe **asistentet** (Gazeta shqiptare, 11.03.2009)*

4. Përdorimet e përemrave

Mekanizmat për vendosjen e marrëdhënieve mes përdoruesve të tekstit përfshijnë dhe burimin e pasur të referencës përemërore. Van Dijk (1998: 203), për shembull, thotë se “ka pak fjalë në gjuhë që mund të jenë të ngarkuara nga ana sociale dhe ideologjike si një *ne* e thjeshtë. Përdorimi i *ne* “përfshirës” presupozon një zonë të

përbashkët mes prodhuesve të tekstit dhe dëgjuesve të presupozuar. Në tekstet e medias, *ne* konsiderohet shpesh si mashkullorë. Një përdorim i tillë bëhet në favor të meshkujve duke i konsideruar femrat si të përjashtuara nga ky grup. Tannen (1996) mendon se kjo prirje për të ndarë gjërat me të tjerët mund të ndikojë në perspektivën e grave për promovim duke qenë se arrijtjet e tyre individuale mund të mos pranohen. Tannen (1996:137) sugjeron se “atje ku shumë burra do të thoshin “*unë*” gratë do të thonë “*ne*”. Nga një analizë e medias shqiptare, vihet re në fakt se këto forma janë të kombinuara. Përemrat *unë* dhe *ne* përdoren të shkëmbyer me njëri-tjetrin nga femrat në politikë dhe nuk duket të jetë një karakteristikë vetëm e diskursit mashkullor.

“**Dua të përsëris** edhe njëherë faktin që e kam deklaruar edhe dy ditë më parë, *ne* si Parti Socialiste **mbetemi** koherentë, në faktin që mbetemi të gatshëm [...] (Shekulli.02.2009) ”

“**Ne** kemi punuar me një njeri korrekt, i cili s’ka dyshime për stafin e tij. [...] Kur ishte dekan ai, **unë** isha me studime master. (Gazeta Shqiptare, 07.03.2009) ”

Gjuha e orientuar drejt të tjerëve ka funksion gjithëpërfshirës, ndërsa mungesa e përemrave vetorë dhe përdorimi i strukturave pësore ose pavetore është tregues i lënies në mënyrë të papërcaktuar të faktorëve, personave që kanë ndikuar që të ndodhë një ngjarje e caktuar.

- ✓ **Zbulohet** vajza që futi Pangon në kurth. (Panorama, 07.03.2009)
- ✓ *Pallati i vdekjes*, **lirohet** ish-sekretarja e KRRT-së së Bashkisë së Gjirokastrës (Gazeta Shqiptare, 31.01.2009)

5. Përdorimi i formave modale

Holmes (1995) jep evidencë empirike në favor të pretendimit se

gratë janë më sensitive se burrat për nevojat e të adresuarve. Një mënyrë sesi kjo manifestohet është përmes përdorimit të dendur të treguesve afektivë të modalitetit, përfshirë folje modale, dhe pjesëza pragmatike si “domethënë” etj.

Modaliteti mund të përfshijë atë që thotë Halliday (1994: 272) si projektme jopersonale (p.sh. mund të ndodhë rasti që), mund ta largojnë veten nga prodhimi i tekstit. Përdorimi i shprehjeve të tilla nga një grua në sferën publike mund të shihet si mungesë autoriteti (Holmes, 1995) pavarësisht se synimi është se janë tregues të solidaritetit social.

“Vërejmë **me keqardhje** se papërgjegjshmëria dhe paaftësia totale e qeverisë ka shkaktuar këto mangësi që kanë vënë në pikëpyetje [...] (Gazeta Shqiptare, 17.02.2009) ”

“**Është për të ardhur keq** që këto shurdhëri, në mënyrë të përsëritur mbajnë peng procesin integrues të Shqipërisë në bashkësinë evropiane (Panorama, 14.02.2009). ”

KONKLUZIONE

- Përsa i përket gjuhës së medias për gratë në politikë, nuk duket të ketë një dallim të dukshëm në mënyrën sesi informacioni jepet për gratë politikane në krahasim me politikanët meshkujt. I gjithë ky information paraqitet në mënyrë objektive, të saktë, dhe pa komente ironike, dhe merret nga veprimtaritë apo prononcimet e tyre.
- Gjuha e përdorur për të gjykuar performancën e roleve të sferës publike mund të jetë dhe e parashikushme dhe stereotipike. Ky studim tregon se karakteristikat leksikore të përdorura nga shumë gra në jetën publike janë të ngjashme me ato të politikanëve meshkuj. Kuptimet e asociuara me njësitë leksikore janë një burim i rëndësishëm e që mund të

përdoret nga prodhuesit e tekstit për të sinjalizuar qëndrimin e tyre ideologjik në lidhje me individët e përfaqësuar.

- Pjesa më e madhe e artikujve janë të shoqëruar dhe nga fotografi të grave në politikë dhe në karrierë. Ndonëse Lakoff (1995:45) thotë se fokusi mbi paraqitjen e grave reflekton largimin nga ajo që ato po thonë, këtu fotografitë luajnë një rol thjesht në kuadrin plotësues të tekstit. Vihet re gjithsesi që fotot paraqesin gratë politikane dhe në karrierë në momente të ndryshme (serioze, më të buzëqeshura, në fjalë e sipër etj) në varësi të përmbajtjes së tekstit. Edhe këtu asociimi i grave me botën e politikës së lartë, që përmes diskursit duhet të konsiderohet si një identifikim me pushtetin, përplasat me idenë e feminitetit, prandaj dhe fotografitë nuk paraqesin këtë anë të femrave në politikë dhe në karrierë.

REKOMANDIME

1. Të dhënat tregojnë një rritje të prezencës dhe të prezantimit të gruas në median e shkruar, gjë që mund të përdoret si një element indikativ dhe krahasues për të ardhmen.
2. Duhet të themi se media luan një rol të rëndësishëm në krijimin e imazhit të gruas dhe rolit të saj në shoqëri për nga përkatësia gjinore. Media nuk duhet të jetë thjesht një pasqyrë e karakteristikave tradicionale, kulturore dhe sociale, media duhet të jetë një agjent ndryshimi me mënyrën e trajtimit të grave dhe për studimet gjinore në përgjithësi.
3. Media duhet të luajë një rol kryesor në procesin demokratik, sepse integrimi i grave në politikat zhvilluese dhe të qëndrueshme të vendit forcon demokracinë dhe është media ajo që duhet të jetë pak më e hapur duke pasqyruar me objektivitet shqetësimet dhe arritjet e grave në të gjitha fushat e jetës po aq sa burrat.
4. Media duhet të jetë më e vëmendshme ndaj perspektivës gjinore duke reflektuar një pasqyrim më të gjerë të grave dhe aktivitetit të tyre. Një vëmendje e veçantë duhet ti kushtohet problematikave që ato hasin në tregun e punës, gjithashtu sfidave me të cilat ato përballen në procesin vendimmarrës dhe atë të politikbërjes.

BIBLIOGRAFIA:

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, 2008: Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje, 2007-2010, Tiranë.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta: Studim i situatës së barazisë gjinore në Shqipëri, 2008, Tiranë.

Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim: Media dhe Barazia Gjinore, 2004, Tiranë.

Nga interneti:

From Beijing Platform for Action. Chapter IV, J. Women and the media.

<http://www.un-documents.net/bpa-4-j.htm>

Discrimination at work- the site.org

<http://www.thesite.org/workandstudy/working/workersrights/discrimination>

Workplace fairness-short-changed-discrimination

<http://workplacefairness.org/sc/discrimination.php>

Strategjia Kombëtare për Barazi Gjinore 2007-2010; Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

Portraying Politics – A toolkit on gender and television; European Commission

Përfaqësimi dhe Cilësia e Demokracisë në Shqipëri- një perspektivë gjinore; 2006; Aleanca Gjinore për Zhvillim; Tiranë

Perspektiva Gjinore në Shqipëri; 2004; INSTAT; Tiranë,

The Global Gender Gap Report 2008; World Economic Forum

“Të drejtat e grave në kontekstin e të drejtave të njeriut”; 2008; Aleanca Gjinore për Zhvillim; Tiranë



